

V E N D I M
Nr.251,datë 20.4.2001

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT “PËRCAKTIMI I HAPËSIRAVE TË
PËRSHTATSHME PËR NDËRTIMIN E DEPOZITAVE BREGDETARE TË NAFTËS,
TË GAZIT DHE TË NËNPRODUKTEVE TË TYRE”**

Në mbështetje të pikave 1 dhe 2 të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e studimit “Përcaktimi i hapësirave të përshtatshme për ndërtimin e depozitave bregdetare të naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të përgatitur nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Për hapësirat e paraqitura në studim, të fillojnë procedurat ligjore për shqyrtimin e tyre, në zbatim të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” dhe të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Ministria e Transportit, Ministria e Punëve Publike dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në bashkëpunim me organet përkatëse të njëjësive të qeverisjes vendore të përgatisin, nëpërmjet institucioneve studimore dhe projektuese në vartësi të tyre, masterplanin e vendosjes së stacioneve të depozitave bregdetare dhe instalimeve portuale, së bashku me infrastrukturën përkatëse në hapësirat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi. Paraqitja e masterplanit për shqyrtim në KRRTRSH të bëhet brenda datës 30.4.2001.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta